



Garante dei diritti  
delle persone private  
della libertà personale  
della Città di Torino

**ASGI**  
Associazione  
per gli Studi Giuridici  
sull'Immigrazione



Università di Torino  
Dipartimento di Giurisprudenza



Ministero della Giustizia  
Dipartimento dell'Amministrazione Penitenziaria  
Direzione della Casa Circondariale "Lorusso e Cutugno"  
TORINO



## Udhëzues për personin e huaj të privuar nga liria personale

**LIGJI I IMIGRACIONIT (QËNDRIMI - SOGGIORNO;  
DËBIMI/PËRJASHTIMI - ESPULSIONE; DHE MBROJTJA  
NDËRKOMBËTARE) – SHËNIME MBI DISA INSTITUTE TË TË DREJTËS  
PENITENCIALE (MBI “LIGJET E BURGJEVE”)**

I shkruar nga:

ASGI APS, Shoqata per Studime Ligjore mbi Emigrazionin  
Klinika Ligjore e Burgjeve dhe të Drejtave II (Departimenti i Drejtësisë, UniTo)

2021

Me kontributin e



Fondazione  
Compagnia  
di San Paolo

## KUJDES!

Në përkthimin e këtij udhëzuesi do të gjeni disa emërtime të përkthyer në gjuhën shqipë në të cilin termi mund mos të jetë i qartë ose mund të duket pa kuptim, sepse në Shqipëri nuk ekzistojnë situata të barabarta me çështjet juridike italiane.

Më poshtë do të gjeni disa terma të cilët në disa raste janë shkruar në italisht në këtë tekst dhe kuptimin e tyre në shqip.

### NË ITALISHT

### NË SHQIP

- a) ARTICOLO (ART)..... NENI
- b) COMMA (CO)..... PARAGRAFI
- c) ESPULSIONE..... PËRJASHTIM NGA VENDI
- d) QUESTURA.....GRUP ZYRASH POLICORE (Komisariat, Polizia ose Dega e brendshme)
- e) ERGASTOLO.....BURGIM I PËRJETSHËM
- f) AFFIDAMENTO IN PROVA..... MIRËBESIM NËN PROVË
- g) SERVIZI SOCIALI.....SHËRBIMET SHOQËRORE
- h) OSTATIVO..... PENGUES (ART 4 BIS)
- i) BENEFICI..... PËRFITIME/FORMA LEHTËSUESE BURGIMI
- j) SUSSIDIO.....MBËSHETJE EKONOMIKE
- k) UFFICIO MATRICOLA..... ZYRA E REGJISTRIMIT
- l) GARANTE.....PERSONI QË KUJDESET PËR TË DREJTAT E TË BURGOSURVE
- m) TESSERA SANITARIA.....LIBREZA SHËNDETSORE
- n) KIT.....GRUP DOKUMENTASH DHE FORMULARESH QË DUHET PLOTËSUAR
- o) PATTEGGIAMENTO..... MARREVESHJE MBI DËNIMIN
- p) TESTO UNICO IMMIGRAZIONE.....KODI I IMIGRACIONIT
- q) CAPITOLO.....KAPITULL OSE (KREU)
- r) PERMESSO DI SOGGIORNO..... LEJE QËNDRIMI
- s) MAGISTRATO DI SORVEGLIANZA..... GJYQTARI I MBIKËQYRJES / I VËZHGIMIT
- t) LA LIBERAZIONE ANTICIPATA..... LIRIM I PARAKOHSHËM

## Përmbledhja

<b>PREZANTIMI .....</b>	<b>5</b>
<b>Kapitulli I. LEJA E QËNDRIMIT .....</b>	<b>6</b>
<b>1.1. SHPJEGIME TË PËRGJITHSHME MBI LEJEN E QËNDRIMIT PËR QYTETARËT JASHTË KOMUNITETIT EVROPIAN .....</b>	<b>6</b>
<b>1.2. PROBLEMI I DËNIMIT (NENI 4 PARAGRAFI 3 KODI I IMIGRACIONIT – T.U.I.) .....</b>	<b>10</b>
<b>1.3. RREGULLORJA E TË DËNUARVE (NENI 4 PARAGRAFI 3) NË BASHKPUNIM ME DISA TIPE LEJESH QËNDRIM .....</b>	<b>11</b>
1.3.1. Leje qëndrimi për arsye pune/ose në pritje punësimi.....	12
1.3.2. Leje qëndrimi për arsye familjare .....	12
1.3.3. Leje qëndrimi për trajtim mjekësor (shëndetësore).....	13
1.3.4. Leje qëndrimi për trajtim mjekësor (shtatëzania) .....	14
1.3.5. Leje qëndrimi për viktimat e trafikimit / skllavërisë dhe të dhunës shtëpiake (për motiv humanitar).....	14
1.3.6. Leje qëndrimi për mbrojtjen e të miturve (Neni. 18 paragrafi 6) .....	15
<b>Kapitulli II. MBROJTJA NDËRKOMBËTARE .....</b>	<b>15</b>
<b>2.1. KËRKESË PËR AZIL DHE LLOJE TË NDRYSHME MBROJTJEJE .....</b>	<b>15</b>
<b>2.2. SI NDIQEN PROCEDURAT .....</b>	<b>17</b>
<b>2.3. ÇFARË PËRGJIGJESH MUND TË JAPË KOMISIONI?.....</b>	<b>17</b>
2.3.1. STATUTI I RIFUGJATËVE DHE MBROJTJA SUBSIDIARIE.....	17
2.3.2. MBROJTJET E VECANTA.....	18
2.3.3. PËRGJIGJA NEGATIVE.....	18
<b>Kapitulli III. PËRJASHTIMI NGA VENDI .....</b>	<b>19</b>
<b>3.1. PËRJASHTIMI/DËBIMI SI PËRMASË ALTERNATIVE APO ZËVENDËSUESE PARABURGIMI(NENI 16 T.U.I.) .....</b>	<b>19</b>
<b>3.2. PËRJASHTIMI NGA VENDI SI PËRMASË SIGURIE (NENI 13 T.U.I) .....</b>	<b>19</b>
<b>3.3. PËRJASHTIMI NGA VENDI ME VENDIM ADMINISTRATIV (NENI 13 T.U.I).....</b>	<b>21</b>

3.4. PËRJASHTIMI NGA VENDI ME VENDIM TË MINISTRISË SË BRËNDSHME (NENI 13 PARAGRAFI 1 T.U.I) .....	24
3.5. RASTE KUR PËRJASHTIMI NGA VENDI ËSHTË I PALEJUESHËM (NENI 19 T.U.I) .....	24
3.6. KTHIMI NE ATDHE/ RIATDHËSIMI VULLNETAR .....	26
<b>Kapitulli IV. LEHTËSIMET QË OFRON BURGUT .....</b>	<b>27</b>
4.1. LEJE DHËNIE .....	28
4.2. LEJE PËR NEVOJA PERSONALE .....	29
4.3. PUNËSIMI BRENDA BURGUT .....	30
4.4. PUNËSIMI JASHTË BURGUT .....	30
4.5. LIRIMI I PARAKOHSHËM .....	30
4.6. MIRËBESIM NË PROVË TEK SHËRBIMET SHOQËRORE/SOCIALE .....	31
4.7. BURGIMI NE SHTËPI.....	33
4.8. GJYSMË-LIRI.....	35
<b>Kapitulli V. TAKIMET .....</b>	<b>35</b>
5.1. TAKIMET NË PREZENCË .....	35
5.2. TELEFONATAT (bisedad telefonike).....	38
<b>Kapitulli VI. BURGUT I RËNDË – SIGURIA E LARTË (ART. 41 BIS O.P.).....</b>	<b>40</b>
<b>Kapitulli VII. TRASFERIMI NË NJË SHTET TJETËR, ANËTAR I BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË KRYER VUAJTEN E DËNIMIT .....</b>	<b>41</b>

## PREZANTIMI

Ky udhëzues është realizuar falë bashkpunimit të ASGI APS, Shoqata për Studime Ligjore mbi Imigrazionin, Klinika Ligjore e Burgjeve dhe të Drejtave II të Departimentit Juridik të Universitetit të Torinos, dhe Zyres së Mbrojtjes së të drejtave të burgosurve të qytetit të Torinos, dhe me kontributin e Kompanisë së San Paolos.

Ky udhëzues është një shtojcë i “Udhëzuesit për të privuarit nga liria personale” i drejtuar të gjithë të burgosurve. Nevoja e tij doli si shkak i numrit të lartë të të burgosurve të huaj që kanë nevojë për informacione mbi marrjen ose ruajtjen e qëndrimit të rregullt në Itali. Për t’ju përgjigjur kësajë nevojë u konsiderua e dobishme të jepen disa informaciona të shkurtra në lidhje me institucionet kryesore ligjore me një vështrim në koordinimin ndërmjet ligjit administrativ, penal dhe atij të imigracionit.

Të dy udhëzuesit mund të jenë një mjet i vlefshëm orientimi në radhë të parë për të burgosurit, por mund të jenë edhe një mjet i vlefshëm për të gjithë operatorët që kryejnë shërbimin e tyre në burgje për arsye të ndryshme. Në këtë studim kanë marrë pjesë studentët Clara Bongiovanni dhe Biancamaria Fasano. Vëzhgimi dhe redaktimi e këtij teksti është kuruar nga tutori i klinikës legale të burgjeve dhe të drejtave II (UNITO) dhe të avokatëve Lorenzo Trucco dhe Donatella Bava (ASGI – APS).

## Kapitulli I. LEJA E QËNDRIMIT

### 1.1. ORIENTIME TË PËRGJITHSHME MBI LEJËN E QËNDRIMIT PËR QYTETARËT JASHTË BASHKIMIT EVROPIAN

Leja e qëndrimit është një dokument që lëshohet nga Kuestura (Komisariati, Dega e brendshme) për qytetarët e huaj, që nuk bëjnë pjesë në Bashkimin Evropian, me qëllim të një qëndrimi të rregullt në Itali.

Pajisja me një leje qëndrimi në Itali, ju lejon të punoni, të merrni kartë shëndetsore (kod fiskal), të keni një vendbanim në mënyrë që të regjistroheni në Zyren e Gjendjes civile, të pajiseni me kartë identiteti dhe të keni akses në të drejtat tuaja (për shembull, kujdesimi mjekësor, strehimi, përfitime dhe mbështetje shoqërore).



[Kur ke të drejtë të kërkesësh një leje qëndrimi?](#)

- Kur hyn në Itali me vizë studimi, pune o familjeje;
- Nëse bashkëjeton me një shtetas italian brenda shkallës së dytë të lidhjes së gjakut/farefisnore (bashkëshorti/ja, fëmijët, vëllezërit, motrat);
- Nëse bashkshorti/ja ka leje qëndrimi;
- Kur je në pritje të një përgjigjeje të kërkesës që ke bërë për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitur në Itali;
- Kur ju është njohur ndonjë formë mbrojtjeje nga shteti italian;
- Nëse je “apolide” (kur nuk ka asnjë shtetësi);
- Nëse jeni autorizuar të qëndroni në territor me vendimin të Gjykatës së miturve sepse keni një fëmijë nën moshën 18 vjeç.



[Keni një leje qëndrimi?](#)

- Leja e qëndrimit ka një skadencë, është e rëndësishme të kërkesësh rinovimin përpara skadencës, përndryshe duhet ta prezantoni brenda 60 ditëve nga skadencia e saj. Mund ta bëni kërkesën edhe nga burgu .

- Pas kësaj periudhe mund të prezantoni kërkesën por është e vështirë që ajo të pranohet nga zyra kompetente. Gjithsesi është e vështirë që Komisariati/Prokura të përgjigjet pozitivisht. Rrezikoni një vendim përjashtimi/dëbimi nga shteti italian, dheqë të shoqëroheni në qendrën e mbatjes kohore- CPR, deri sa t'ju transferojnë.
- Është e rëndësishme që të kërkonte rinovimin e lejes gjatë kohës që jeni në burg: në disa raste mund të rinovoni lejen e qëndrimit që keni, ndersa në disa raste të tjera ja vlen të vërtetoni nëse është e mundur të kërkonte leje qëndrimi për arsye të tjera.

### ? NUK KENI NJË LEJE QËNDRIMI ose leja juaj e qëndrimit ka shumë kohë që ka skaduar?

Ka disa raste kur mund të kërkonte një leje qëndrimi edhe nëse nuk e keni pasur më parë, ose rëse ka kaluar shumë kohë nga skadenca e saj dhe nuk e keni rinovuar. Ja disa shembuj:

- **Në qoftë se keni probleme shëndetsore** > kontrolloni nëse keni mundësi për të pasur një leje qëndrimi për kujdesje mjekësore (shiko 1.3.3.):
- **Nëse keni frikë të ktheheni në vendin tuaj** sepse jeta juaj është në rrezik > kontrolloni nëse ekzistojnë kushtet për të aplikuar për azil (shiko kapitullin e II);
- **Nëse keni anëtarë të familjes (italian ose të huaj) në Itali** > kontrolloni nëse mund të kërkonte për leje qëndrimi për arsye familjare (shiko 1.3.2.);
- **Nëse keni fëmijë nën moshën 18 vjeç dhe nuk i keni humbur të drejtat dhe detyrimet kundrejt fëmijës** > flisni me një avokat për të kuptuar nëse mund të bëni një ankese në Gjykatën e të Miturve për të marrë leje qëndrimi për këtë motiv (shiko 1.3.2.)
- **Nëse gjeni kushte vërtet të veçanta si në Itali apo në vendin tuaj** > kontrolloni nëse çështja juaj i përket rasteve të veçanta të lejes së qëndrimit të parashikuara nga ligji duke folur me avokatin, me operatorët, me vullnetarët ose me zyrën e Garantit.

**KUJDES!** Nëse NUK keni leje qëndrimi, **mund të përjashtoheni/dëboheni drejt shtetit tuaj**, ose në momentin që jeni në burg, ose pas përfundimit të dënimit (Në çdo moment) (shiko kapitullin III). Nëse keni leje qëndrimi dhe nuk bëni kërkesë rinovimi brenda 60 ditëve nga skadenca e lejes, ktheheni në i parregullt dhe gjithashtu mund të përjashtoheni nga vendi (shiko kapitullin III).

## ? çfarë mund të bëni nëse leja juaj e qëndrimit është duke skaduar?

Tre muaj përpara se të skadojë leja e qëndrimit, nisni procedurat e dokumentave për të rinovuar lejen e qëndrimit. Koha për kërkesën e rinovimit në institut mund të jetë e gjatë, informohuni dhe veproni në kohë.

## ? Si mund të rinovini lejen e qëndrimit?

- Nëse ndodheni në burg, për të bërë lejen e qëndrimit, në përgjithësi duhet të pyesni zyrën e komandës (l'Ufficio Comando), dhe ti kërkonti një **KIT për rinovimin** e lejes së qëndrimit (por procedurat mund edhe të ndryshojnë, **kontaktoni stafin e Institutit për shpjegime të mëtejshme, ose Garantin e të te dënuarve** ).
- Procedura më tej do të ndiqet nga zyra e matrikullimit të institutit ku ndodheni, e cila do të merret me dërgimin e kitit të kompletuar në postës për ta dërguar në adresën e Komisarariatit kompetent.
- Zyra e matrikullimit (regjistrimit) duhet t'ju kthejë një fletë që është prova e dërgimit të praktikës së (Kitit): ruajeni këtë dokument sepse provon që jeni i rregullt ne territor.
- **Praktika (kiti) duhet të plotësohet nga ju.** Mundë ti kërkonti ndihmë avokatit tuaj, ndonjë operatori, ose vullnetarëve te zyrës së Garantit për plotësimin e dokumentave.
- Mos u shqetësoni nëse nuk merni përgjigje të menjëhershme: **kërkesa që keni bërë ju mban të rregullt në shtetin italian** deri sa të merni përgjigje nga komisarati. **Kundër përgjigjes negative mund të provoni prapë për të bërë letrat, por gjithmonë nëpërmjet një avokati (shiko me poshtë).**

Për të bërë kërkesën e lejes së qëndrimit, ju duhet të bashkangjisni disa **DOKUMENTE**:

- **Kopjen e lejes së qëndrimit** (permesso di soggiorno) **që është duke skaduar;**
- **Kopjen e pashaportës;**
- **Kopjen e kartës të identitetit italian dhe të librezës shëndetsore** që përmban kodin fiskal (nëse nuk i keni mund ta dërgoni kitin gjithsesi) - (kiti janë dokumentat që duhen plotësuar);
- **Pullë me vlerë 16 € (marca da bollo);**

- Duhet të paguani gjithashtu edhe koston e nisjes postale (zakonisht është e barabartë e një pagese 30,46 € + 30 €).

Në bazë të llojit të lejes së qëndrimit që kërkon, duhet të prezantoni edhe dokumenta shtesë. Për shembull, nëse kërkon rinovimin e lejes së qëndrimit për arsye familjare, do të nevojiten fotokopjet e dokumentave të anëtareve të familjes suaj. Nëse kërkon rinovimin e lejes për kurim mjekësor, do t'ju duhen dokumentat shëndetësore. **Për disa rinovime lejesh të tjera kërkesa bëhet direkt në Komisarjat. Nëse zyra e matrikullimit ju komunikon këtë,** vihuni në kontakt me avokatin tuaj, me një operator të besueshëm ose me zyrën e Garantit për informacione të mëtejshme.

<p><b>ËSHTË E RËNDËSI SHME</b></p>	<p><b><u>PËRGJIGJIA NEGATIVE MBI KËRKESËN E LEJES SË QËNDRIMIT</u></b></p> <p>Nëse merrni përgjigje negative ndaj kërkesës së lejes,</p> <p>kontaktoni avokatin tuaj <b>MENJËHERË</b>. Së bashku ju mund të paraqiteni përpara një Gjykatësi i cili do të rishikojë situatën tuaj.</p>
--	--

<p><b>ËSHTË E RËNDËSISHME</b></p>	<p><b><u>SHËRBIMI I AVOKATIT TE ZYRËS (avvocato d'ufficio)</u></b></p> <p>Në të gjitha procedurat administrative që zhvillohen përpara një Gjykatësi (kundërshtimi juaj kundër një vendimi negativ të lejes së qëndrimit, kundërshtimi juaj kundër vendimit të përjashtimit nga shteti italian) ju duhet të mbroheni nga një avokat.</p> <p>Për të bërë këto kërkesa NUK emërohet një avokat zyre (avokat zyre nuk do të thot avokat pa pagesë). Nëse nuk keni një avokat të besueshëm, kërkon ndihmë nga një operator ose nga Garanti i të drejtave të burgosurve.</p>
---------------------------------------	---

<p><b>ËSHTËE RËNDËSI SHME</b></p>	<p>Nëse nuk keni mundësi të paguani një avokat sepse nuk keni të ardhura ose të ardhurat tuaja janë të ulta, keni të drejtë për mbrojtjen falas (Gratuito Patrocinio). Kjo do të thotë që t'ju japin një avokat i cili do të pagohet/rimbursohet nga shteti.</p> <p>Shërbimi falas i avokatit mund të merret si në procedurat administrative, (per leje qëndrimi, përjashtim nga vendi) gjithashtu edhe në procedurat përpara një Gjykatësit ose Gjykates se Mbikqyrjes (Gjykatësi i mbikqyrjes së burgut për përfitimet/lehtësimet e burgimit – Misure alternative).</p>
-----------------------------------	---

**?** A keni të drejta në burg edhe nëse nuk keni një leje qëndrimi të vlefshme?

Në burg edhe pse ju nuk keni një leje qëndrimi, mund të punoni, keni të drejtë për shërbime dhe kurime mjekësore, dhe nëse plotësoni kushtet mund edhe të kërkonit lehtësimet e burgimit (misurat alternative) . Por kur të mbaroni dënimin, humbasni të drejtën për të punuar.

**1.2 PROBLEMI I KRIMIT TË RËNDË (NENI 4 PARAGRAFI 3, KODI I EMIGRACIONIT - TUI)**

**?** Të jeshë i akuzuar për kryerjen e një krimi penal (edhe nëse nuk jeni akoma te DËNUAR përfundimisht) është një problem për lejen e qëndrimit?

Po, mund të jetë një problem në përgjithësi, **ju nuk mund të keni leje qëndrimi (ose nëse e keni mundet edhe t'jua heqin) nëse:**

a) Jeni i konsideruar si një kërcënim për rendin publik ose për sigurinë e shtetit italian, ose për shtetet e tjera të Bashkimit Evropian.

b) **Keni** marrë një dënim, qoftë edhe vetëm në shkallë të parë të **gjkimit**, dhe rrjedhimisht jo ende përfundimtar. Ose në rast të një vendim dënimi për marrëveshjen e fajësisë për një nga veprat e përmendura në Nenin 380 paragrafi 1 dhe 2 të kodit Penal (nëse dënimi i parashikuar nga ligji është veçanërisht i rëndë dhe për disa krime duke përfshirë grabitjen, vjedhjen e rëndë, zhvatjen/shantazhin, pranimin/marrjen e mallrave të vjedhura kur është parashikuar si i rëndë, skllavërimin, dhunën seksuale);

c) Keni pasur vendim dënimi me burg, qoftë edhe vetëm në shkallë të parë dhe përrjedhojë jo ende përfundimtar, ose një dënim me marrëveshje për disa krime specifike:

- Në fushën e lëndëve narkotike;
- Kundër lirisë seksuale;
- Favorizim i imigrimit të paligjshëm ose të emigrimit drejt vendeve të tjera;
- Kush synon rekrutimin e personave për të përdorur në prostitucion ose të miturit për të përdorur për veprimtari të palejueshme dhe të pa ligjshme.

**?** [Të kesh një dënim përfundimtar është problem për lejen e qëndrimit?](#)

**Po, përse i përket të gjitha rasteve të mësipërme, dhe nëse dënimi është për:**

- Shkelje ligji që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtës së autorit;
- Neni 473 i kodit penal (falsifikim ose ndryshim i shenjave dalluese shtetërore, markave tregtare);
- Neni 474 i kodit penal (tregtia e prodhimëve me shenja të falsifikuara);

Blllokimi i hekurudhave dhe të rrugëve normale, po gjithashtu dhe të ujrave për pengesë kalimi të anijeve/për të parandaluar lundrimin.

### **1.3. RREGULLI I KRIMEVE E RËNDË (NENI 4 PAR 3 TUI) NË LIDHJE ME DISA LLOJE TË CAKTUARA LEJE QËNDRIMI**

Rregulli i mësipërm mbi krimet e rënda në pikën 2 zbatohet në përgjithësi, por aplikimi i tij në praktike varet nga tipi i lejes së qëndrimit që keni kërkuar; për disa lloje lejesh qëndrimi rregulli i dënimeve për krimet e rëndë është më i lehtë. Në raste të tjera, mund të merret lejë qëndrimit edhe në prani të krimeve të rënda (shiko 1.3.2., 1.3.3., 1.3.4., 1.3.5., 1.3.6.)

### 1.3.1 LEJE QËNDRIMI PËR PUNËSIM OSE PËR PRITJE PUNËSIMI

Nuk mund të aplikoni për të nëse nuk keni pasur kurrë leje qëndrimi dhe është tipi i lejes më i vështir për tu bërë.

Nëse nuk keni kryer asnjë nga krimet e përmendur më sipër, dhe jeni duke mbaruar dënimin, dhe leja juaja e qëndrimit është afer skadencës, mund të bëni kërkesë për të rinovuar lejen e qëndrimit për arsye pune. Kjo mund të bëhet kur mund të provoni që keni një kontratë pune, ose ndonjë punëdhënës të gatshëm t'ju punësojë, dhe të keni lidhje familjare në territorin italian.

Kontaktoni **Garantin ose avokatin tuaj për ndihmë.**

### 1.3.2. LEJE QËNDRIMI PËR ARSYE FAMILJARE

Ekzistojnë shumë raste kur mund të jepet një leje qëndrimi për arsye familjare.

Rregullat për lëshimin dhe rinovimin e lejes për këtë arsye janë të ndryshme dhe varen nga rasti.

Ekzistenca e një krimi penal nuk është një arsye e mjaftueshme për të vendosur mosmarrjen e lejes së qëndrimit për arsye familjare.

? [Nëse keni leje qëndrimi për arsye familjare, mund të aplikoni për rinovim?](#)

Po, mund të kërkonte rinovimin e lejes së qëndrimit, por nëse ju jeni akuzuar për krime të rënda, komisariati mund të vendosë që të mos t'ju rinovojë lejen e qëndrimit. Nuk duhet të jetë një vendim automatikisht negativ, sepse duhet të merren për bazë lidhjet familjare në Itali, dhe të vlerësohen me kujdes krimet penale që janë kryer. Duke vlerësuar nëse krimi i kryer është i rëndë apo i lehtë.

Leja e qëndrimit mund ta kërkohe me KIT POSTAL - (duhet të kërkonte **kitin postal tek zyra Matrikullimit, dhe kërkonte ndihmë avokatit tuaj apo ndonjë vullnetari për të plotësuar kitin**).

? [Nëse nuk keni leje qëndrimi për arsye familjare, por keni një familjar në Itali, a mund të kërkontë për të bërë letrat?](#)

Në disa raste po, nëse nuk ka kaluar me një vit nga skadenca e lejes së qëndrimit tuaj; në raste të tjera, gjithmonë. Por edhe në këto raste komisariati mund të marrë vendim negativ, dhe të vendosë që të mos ju rinovojë lejen, nëse ju keni bërë krime të rënda. Përveç kësaj, është e nevojshme të vërtetoni se keni të ardhura të mjaftueshme.

<b>ËSHTË E RËNDËSISHME</b>	<p>Nëse keni <b>FËMIJË TË MITUR</b>, kontrolloni me avokatin tuaj nëse mund të kërkontë lejen e qëndrimit në gjykatën për të mitur në baze të Nenit. 31 par. 3 TUI.</p> <p>Nëse keni familjar italian (gruan, burrin, fëmijë, prindër dhe vëlla e motër) <b>ME TË CILIT TI JETOJE PARA SE TË HYJE NË BURG</b>, mund ta kërkontë leje qëndrimi për arsye familjare, sipas Nenti 19 paragrafi 2 gërma c) TUI</p>
----------------------------	--

### 1.3.3. LEJE QËNDRIMI PËR TRAJTIM MJEKËSOR (SËMUNDJE)

**Edhe nëse keni kryer krime të rënda, nëse gjendja juaj shëndetësore është veçanërisht e rëndë**, mund të aplikoni për një leje qëndrimi për trajtim mjekësor. Kjo lloj lejeje mund të kërkohej edhe nëse nuk keni pasur kurrë më parë leje qëndrimi ose nëse ajo që kishit ka skaduar prej disa kohësh ( [neni 19 co 2 lett.d bis](#)).

Për tu lëshuar kjo leje qëndrimi:

- duhet të bëhet fjalë për një sëmundje veçanërisht të rëndë (si p.sh. një Kancer);
- sëmundja duhet të jetë e vërtetuar me një dokument zyrtar ASL (duhet të bashkëngjiteni dokumentet e mjekut që vërtetojnë sëmundjen në KIT postar;
- për të marrë certifikimin, kontaktoni Departamentin e Shëndetësisë të Institutit tuaj në të cilin ndodheni;

- Duhet të vërtësohet që sëmundja **nuk mund të trajtohet në shtetin tuaj të origjinës**, dhe për këtë arsye do të ishte e rrezikshme për ju që të ktheheshit.

#### 1.3.4. LEJE QËNDRIMI PËR TRAJTIM MJEKËSOR (SHTATËZANIA)

Mund të aplikoni për leje qëndrimi për trajtim mjekësor edhe nëse jeni grua në gjendje të konfirmuar shtatëzanie dhe deri në 6 muaj pas lindjes së fëmijës ( [neni 19 ko 2 germa d](#)).

**Edhe nëse jeni babai** i fëmijës që do të lind, mund të kërkonti këtë leje qëndrimi: **drejtohuni avokatit tuaj**; procedura është e ndryshme në varësi të faktit nëse jeni i martuar me nënën e fëmijës që do të lindë apo jo.

Në këto raste nuk zbatohet rregulli i veprave të renda, përveç rasteve kur konsideroheni si rrezik për sigurinë e shtetit italian ose të shteteve të tjera të Bashkimit Evropian.

#### 1.3.5. LEJE QËNDRIMI PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT/ SKLLAVËRISË DHE DHUNËS SHTËPIAKE (PËR ARSYJE HUMANITARE)

Nëse jeni viktimë e skllavërisë ose jeni keqtrajtuar në familje mund të merrni një lejeqëndrimi për arsye humanitare. **Drejtohuni avokatit tuaj**, një operatori ose Garantit **për të hyrë në lidhje me institucionet që mund t'ju shpjegojnë e t'ju shoqërojnë në këte rrugë.**

- **VIKTIMAT E SKLLAVËRISË/TRAFIKIMIT.** Nëse keni qenë viktimë e trajtimit ose mbajtjes në skllavëri ose në trafikim njerëzor (për shembull, nëse keni ardhur në Itali dhe ju detyruan të merrenit me prostitucion për të paguar borxhin dhe nuk ishit e lirë të largoheshit), mund të aplikoni për një leje qëndrimi që përfshin gjithashtu programe asistence të cilët garantojnë ushqimin, banimin dhe shërbimshëndetësor.

- **DHUNA NË FAMILJE.** Jeni konsideruar viktimë e dhunës në familje kur keni pësuar keqtrajtme dhe dhunë fizike (shqelma, grushta, shuplaka, kafshime, etj.), ose dhunë seksuale, psikologjike (kërcënime) ose ekonomike, dhe kjo dhunë ndodh brenda familjes ose martesës ose një marrëdhënie. Për të marrë këtë leje NUK është e nevojshme që personi që ka kryer dhunën të jetojë në të njëjtën shtëpi me personin që e ka vuajtur dhunën.

### 1.3.6. LEJE QËNDRIMI PËR MBROJTJEN SHOQËRORE E ISH-TË MITURIT (NENI 18 PAR. 6 TUI)

Kjo leje qëndrimi mund ti jepet atyre, **QË KA PAK KOHË QË KANË MBUSHUR 18 VJEÇ NË MOSHËN E PJEKURISË, edhe në rastin** E kryerjes së krimeve të **rëndë**.

Nëse ndodheni në burg sepse keni kryer një krim **kur ishit akoma i mitur**, (dhe nga burgu i të miturveve keni kaluar në atë të moshave të mëdha) **keni marrë pjesë në PROGRAMIN E NDIHMËS PËR INTEGRIM SHOQËROR** (të financuara nga shteti dhe të organizuara nga organet sociale ), mund të kërkonit që leja juaj e qëndrimit për moshë të mitur të shndërrohet ose të zëvendësohet me leje qëndrimi për mbrojtjen shoqërore.

<b>ËSHTË E RËNDË SISHME</b>	Kjo leje qëndrimi mund të të lëshohet edhe me propozim të Prokuratorit të Republikës ose të <b>Gjykatësit mbikëqyrës të Gjykatës per të mitur</b> , te ciles <b>mund ti shkruani një letër ku parashtrohet dhe prezantohet kërkesa juaj.</b>
---	--

## Kapitulli II. MROJTJA NDËRKOMBËTARE

### 2.1 KËRKESA PËR AZIL DHE LLOJET E NDRYSHME TË MBROJTJEVE

Nëse ndodheni në burg dhe mendoni që kthimi në vendin tuaj është i rrezikshëm për jetën tuaj, mund të vlerësoni për të bërë kërkesë për azil, me ndihmën e avokatit tuaj, të Garantit dhe të klinikës ligjore (Clinica legale) Ndërkombëtare të Universitetit të kolegjit (International University College – IUC). Mund të bëni kërkesë azili kur:

a) Në vendin tuaj, ju mundi nënshtroheni dhunës për arsye që lidhen me racën, fenë, kombësinë ose opinionin tuaj politik, ose sepse jeni pjesë e një grupi njerëzish me karakteristika të veçanta (**STATUSI I REFUGJATIT - STATUS DI REFUGIATO**). Në këtë rast ju do të keni këto motive për të kërkuar leje për azil, **për shembull:**

- Nëse keni refuzuar të kryeni shërbimin ushtarak dhe për këtë arsye mund t'ju bëjnë ndonjë proces për t'ju dënuar;
- Nëse jeni i kërkuar nga policia, sepse ju akuzojnë për arsye politike;
- Nëse jeni të diskriminuar/i nënshtroheni dhunës për arsye të orientamentit dhe bindjeve tuaja seksuale.

b) Në atdheun tuaj mund të të pësoni dëmtime serioze mbi personin tuaj. Kjo ndodh kur: ka ndonjë luftë; ose jeni i dënuar me vdekje; ose nëse ktheheni në vendin tuaj mund të rrezikoni nënshttrimin e dhunës ose të torturës (**MBROJTJE SUBSIDIARE - PROTEZIONE SUSSIDARIA**).

**KUIDES!** Nga momenti i kërkesës për azil, duhet të ndërprisni marrëdhënjet me autoritete e shtetit tuaj (për shembull Ambasadën, Konsullatën etj.) dhe nëse keni pashaportën, duhet ta dorëzoni përkohësisht në komisariat. Nëse do ju njihet statusi i refugjatit nuk mund të riktheheni më në atdhe. Nëse ktheheni do të humbisni statutin e refugjatit dhe rrjedhimisht lejen e qëndrimit.

## ? Kush janë njerëzit që mund t'ju bëjnë keq?

Frika e dhunës që mund t'ju shkaktohet mund të vijë nga forcat e shtetit (për shembull, nga policia, ushtarakët) ose nga civilët (për shembull **përsonat e një grupi kriminel**, një grup politik ose fetar në kundërshtim me pozicionin tuaj, por edhe anëtarë të familjes ose fqinjëve të shtëpisë.). Në shembullin e dytë duhet të vërtetoni që shteti juaj (policia, Gjykatësit etj etj) **NUK** mund tju mbrojnë.

## 2.2 **SI ZHVILLOHET PROCEDURA?**

Për të bërë kërkesë azili, ju lutemi raportoni situatën tuaj tek një edukator dhe/ose **Garantit che ata do t'ju ndihmojnë në ndjekjen e procedurës**. Mund të takoni studentët e klinikës ligjiore të Universitetit IUC di Torino, që do ju ndihmojnë të kuptoni nëse është e mundur që të bëni kërkesë për azil dhe që do ju ndihmojnë ta përgatisni atë. Kërkesa dërgohet nëpërmjet zyrës së matrikullimit në komisariat (Questura).

Në formularin e kërkesës duhet të tregoni shkurtimisht arsyet për të cilat po aplikoni për azil. Formulari duhet të plotësohet **me ndihmë të një përkthyesi** të një gjuhe që ju njihni. Është gjithashtu e rëndësishme të **dërgoni** çdo **dokument** që mund të merrni për të vërtetuar arsyet e kërkesës

**Nëse keni paraqitur kërkesë azili ju nuk mund të përjashtoheni nga vendi derisa kërkesa juaj të jetë shqyrtuar.** Duhet të mbani gjithmonë me vete një kopje të formularit me të cilin keni bërë kërkesën (mund ta kërkonte te zyra e matrikullimit të burgut). Ndërsa prisni përgjigjen, ju jepet një **leje qëndrimi për kërkesë azili**.

Pasi të keni prezantuar kërkesën për azil, do të intervistoheni nga një pjestar i Komisionit Territorial. Komisioni është një organ publik, i cili është NDRYSHE nga Gjykatësi dhe policia. **Çdo gjë që thoni përpara Komisionit është e REZERVUAR DHE KONFIDENCIALE.**

Intervistuesi **do t'ju bëjë pyetje mbi jetën tuaj në vendin tuaj të origjinës dhe mbi jetën që bëni në Itali**, për të kuptuar situatën tuaj dhe për të vlerësuar rrezikun se çfarë rreziqesh ka për ju në vendin tuaj, në rast të dëbimit. Gjatë takimit do të jetë i pranishëm një përkthyes në gjendje të flasë në gjuhën tuaj.

## 2.3. CILAT JANË PËRGJIGJET QË MUND TË JAPË KOMISIONI?

### 2.3.1. STATUSI REFUGJATIT DHE MBROJTJE SUBSIDIARE

Nëse kërkesa juaj për azil pranohet, do t'ju njihet **statusi i refugjatit** ose i **mbrojtja subsidiare**. Mund të merrni një **leje qëndrimi pesë vjeçare** (5 vjet) kështu që do qëndroni ligjerisht në territorin Italian.

### 2.3.2. MBROJTJA E VEÇANTË

Nëse Komisioni mendon që nuk janë kushtet për mbrojtjen ndërkombëtare, por sidoqofte:

- Ka gjithësesi një rrezik që ju mund të jeni i **persekutuar ose torturuar, sepse në atdheun tuaj vazhdon të ketë shkelje të rëndësishme të drejtave të njeriut.**
- Pranon se jeta e personit që ka aplikuar për azil është e rrënjësuar thellë në Itali (sepse ka lidhje të forta familjare ose ka qenë larg vendit të tij të origjinës për një kohë të gjatë dhe tani është i integruar në Itali).

Mund t'ju njihet MBROJTJA E VEÇANTË. Në këtë rast **mund të pajiseni me leje qëndrimi 2 vjeçare.**

Komisioni mund ti sygjerojë kuesturës lëshimin e lejes së qëndrimit për arsye të tjera të veçanta.

### 2.3.3. PËRGJIGJE NEGATIVE

Nëse kërkesa juaj për azil, nuk pranohet dhe nuk ju njihet mbrojtja e veçantë, ju mund të jeni i përjashtuar nga vendi ku keni aplikuar. **Keni mundësi që ta kundërshtoni këtë vendim brenda 15 ose 30 ditëve nga përgjigjia negative: kërkoni ndihmë avokatit për të bërë një apel në gjykat.**

**KUIDES!** Nëse keni kryer KRIME TË RËNDA, kjo mund të jetë problem për njohjen e mbrojtjes së veçantë. Është e rëndësishme që ju ta keni parasysh kur të bëni kërkesën.

## Kapitulli III. PËRJASHTIMET NGA VENDI

Nëse nuk keni leje qëndrimi ë vlefshme ose nuk keni paraqitur kërkesë për leje qëndrimi, ose në disa rrethana të tjera te veçanta, ju **mund të ndodheni në një situatë ne te cilen nuk është e mundur të qëndroni në Itali** .

**Mund të merrni dënim me përjashtim nga vendi:** vendimi për riatdhesimin mund të merret në kohën e qëndrimit tuaj në burg ose pasi te liroheni nga burgu. Kështu që përjashtimi mund të jetë administrativ ose penal (ndëshkues).

### 3.1. PËRJASHTIMI NGA VENDI SI PËRMASË ALTERNATIVE OSE ZËVENDËSESE E BURGUT (NENI. 16 – KODI I IMIGRACIONIT - TUI)

? [Kur mund të përjashtoheni nga vendi për të mos vuajtur dënimin në burg?](#) Kjo llojë përmase mund të urdhërohet si **PËRMASË ZËVENDËSUESE** e dënimit kur:

- **Ju ndodheni në situatat e përshkruara në Nenin 13 par. 2 T.U.I.: jeni i parregullt në Itali** (shikoni 3.3.) E
- Gjykatësi ju dënon me vuajtje dënimi me burg **POSHTË 2 viteve, por nuk janë kushtet për të marrë pezullimin e dënimit** (dënim me kusht).

Nëse vendoset të zëvendësohet dënimi me burg me përjashtimin nga vendi, komisariati mund t'ju riatdhesojë në çdo moment, edhe pse keni bërë apel kundër dënimit të shkallës së parë të gjykimit.

Ndërsa, përjashtimi nga vendi mund të **KONSIDEROHET SI ALTERNATIV** i dënimit kur ju:

- **Ndodheni në situatat e përshkruara nga Neni 13 par. 2: jeni i parregullt në Itali** (shikoni 3.3.)
- **Po vuani dënimin në burg dhe ju kanë mbetur më PAK se 2 vjet vuajtje dënimi.**

Në këtë rast, drejtorja e institutit ku ndodheni, i kërkon komisariatit të identifikojë personin tuaj (identitetin dhe shtetësinë). Urdhëri i përjashtimit nga vendi vendoset nga GJYKATËSI I

MBIKQYRJES së burgut: **kundër këtij vendimi mund të protestoni personalisht ose nëpërmjet avokatit tuaj brenda 10 ditësh e jo më tepër.** Vendimin e gjyqtarit mund ta KUNDËRSHTONI personalisht ose nëpërmjet nje avokati BRENDË 10 DITËVE.

**KUJDES!** NUK emërohet një avokat zyre (avvocato d'ufficio) për kundërshtimin e vendimit tëpërjashtimit nga vendi.

Nëse kundërshtoni vendimin, do të keni një seancë përpara Gjykatësit të mbikqyrjes së burgut: në këtë rast, nëse nuk keni avokat përsonal, do t'ju vihet në dispozicion një avokat zyre për zhvillimin e kësaj seance.

? Mund të kthehesh në Itali pas ndëshkimit me përjashtim nga vendi?

Jo, sepse bashkë me urdhërin e përjashtimit nga vendi, është edhe ndalimi që të ktheheni në Itali. Nëse përjashtoheni nga vendi italian kohëzgjatja e ndalimit të rihyrjes në Itali do të varet nga lloji i krimit që keni kryer (nga 3 deri në 5 vjet për krimet e dënueshme me gjobë dhe më pak të rënda; në raste të tjera jo më pak se 5 vjet ).

? Kur përjashtimi NUK mundë të zëvendësojë dënimin e marrë?

Përjashtimi NUK zëvendëson dënimin kur:

- **Ndodheni në burg sepse krimet e juaja janë shumë të rënda** (sidomos ata që permbahen ne Nenin. 407, par. 2 germa a) të kodit të përçedurës penale, si për shembull shoqata të tipit mafioz, krime me qëllime terroriste, zhvatje (estorsione), vrasje, rrëmbim e të tjera; ose kur
- Gjendeni në burg sepse keni bërë ndonjë nga krimet e parashikuara ne Kodin e Imigracionit T.U.I dhe jeni dënuar me një dënim më shumë se dy vjet burg; ose kur
- **Ligji e pengon përjashtimin nga vendi, sepse gjendeni në një situatë të veçantë** (shikoni 3.5.).

**KUJDES!** Nëse ktheheni ilegalisht në Itali, pas përjashtimit të shteti italian, në këtë rast përmasa e përjashtimit anulohet, **dhe duhet do të ktheheni në burg per te perfunduar dënimin deri në fund.**

## 3.2. PËRJASHTIMI SI PËRMASË SIGURIE (NENI 15 TEKSTI I VEÇANT I IMIGRIMIT)

Përrjashtimi si përmasë sigurie mund të urdhërohet nga Gjykatësi në vendim, nëse rezultoni si person i rrezikshëm, dhe keni kryer krime veçanërisht të rënda (ish Nenet 380 – 381 c.p.p.).

Në këtë rast, pasi t'ju kanë shoqëruar në burg ose ndërkohë që po bëhet procedura penale, me vendim përfundimtar, do të lajmërohet kuestori i komisariatit dhe Autoritetet e Konsullatë, të cilët do të nisin procedurën e identifikimit. Në fund të vujtjes së dënimit do të përjashtoheni.

**KUJDES!** Në Përfundim të vujtjes së dënimit, Gjykatësi i mbikqyrjes duhet gjithsesi të vërtetojë rrezikshmërinë sociale përpara se të aplikojë përmasën e

## 3.3. PËRJASHTIMI ADMINISTRATIV (ART. 13 T.U.I)

? Në cilat raste mund përjashtoheni nga vendi?

Ju mund të përjashtoheni nga vendi në formë Administrative nëse:

1. Nëse ju keni hyrë në Itali në mënyrë të parregullt;
2. Nëse nuk keni më lejen e qëndrimit sepse ka skaduar dhe nuk keni kërkuar në kohë rinovimin e saj, ose keni prezantuar prap por jua kanë refuzuar, ose komisariati ju ka terhequr lejen e qëndrimit;
3. Nëse ju jeni i konsideruar si person i rrezikshëm për publikun, sepse merreni me trafikë të paligjshme në mënyrë rutinore ilegalisht dhe mirëmbaheni përmes këtyre aktiviteteve të paligjshme; kur kryeni vepra penale kundrejt të miturve, shëndetshisë, sigurisë dhe qetësisë publike; jeni i dyshuar si pjesmarës i organizatave kriminale të tipit mafioz (hipotezë e nenve 1.4.16 i D. Lgs: 159/2011).

**KUJDES!** Nëse keni ushtruar të drejtën tuaj për bashkim familjar ose keni lidhje familjare në Itali ose keni jetuar atje për një periudhë të gjatë kohore, **autoritetet duhet të vlerësojnë situatën tuaj familjare përpara se të lëshojnë një urdhër përjashtimi.**

## ? Si mund të vijë përjashtimi nga vendi?

Përjashtimi nga shteti italian, është një vendim që merret nga **Prefekti**, nëpërmjet komisariatit. Nëse pas daljes nga burgu, policia ju ndalon dhe vërteton parregullsinë tuaj, mund t'ju shoqërojnë në komisariat dhe t'ju japin përjashtim nga territori italian.

<b>ËSHTË E RËNDËSHISHME</b>	<b>Kur ju japin një vendim për përjashtim mund të kundërshtoni këtë akt brenda 30 ditëve tek Gjykatësi i Paqes.</b> Duhet të kërkoni një avokat për të bërë apelin. Nëse nuk jeni në gjendje të paguani një avokat, keni të drejtë të kerkoni shërbimin ligjor pa pagesë, në shpenzime të shtetit.
-------------------------------------	--

Pas marrjes së vendimit të përjashtimit:

- **Mund të shoqëroheni menjëherë në kufi** (ndodh rrallë);
- **Mund të dërgoheni në një qendër riatdhesimi (CPR)** ku do të mbaheni në atë qendër qëndrimi deri sa të organizohen për t'ju nisur drejt vendit tuaj;
- Nëse keni pashaportën dhe një venbanim, Kuestori mund të vendosë për ju **një përmasë alternative** nga ajo e qendrës për riatdhesimin (per shembull: detyrim paraqitje në komisariat për të firmosur);
- Kuestori mund t'ju japë një afat kohor për tu largohuar vullnetarisht nga territori italian (për shembull nga 7 deri në 15 ditë), dhe t'ju lërë të lirë që të largoheni vetë (**largim vullnetar**). Nëse nuk e respektoni këtë limit kohor, mund t'ju dërgojne në qendër për riatdhesim.
- Nëse nuk është i mundur shoqërimi i menjëhershëm në kufi (në aeroport) ose nuk ka vënd në qendrën e riatdhesimit, Kuestori mund t'ju lejë të lirë me urdhër që të largoheni në mënyrë të pavarur brenda 7 ditëve. **Nëse nuk e respektoni mund të rrezikoni një procedim penal dhe të mbaheni në qendër për riatdhesim (CPR).**

## QENDRA E PËRKOSSHME PËR RIATDHESIM

Nëse dërgoheni në këtë qendër, **do mbahet një seancë para gjykatësit, i cili do të vendosë nëse do të mbaheni në qendën për riatdhesim ose jo.** Mund të ndiqeni nganje avokati juaj ose, nëse nuk keni avokat, do t'ju vihet në dispozicion një avokat zyre. Gjatë qëndrimit tuaj, Komisariati do të duhet t'ju identifikojë dhe të marrë dokumentet për riatdhesim.

**Edhe në qendrat për riatdhesim (CPR) operojnë Garantët për të drejtat e të dënuarve.** Mund t'ju drejtoheni atyre gjatë qëndrimit në qendrën e mbajtjes për riatdhesim, duke kërkuar një takim me ta për shpjegimin e problemit tuaj dhe përshkeljen e të drejtave tuaja, ose mund të lini një deklaratë me shkrim.

### [?Për sa kohë duhet të qëndroni në qendrën e mbajtjes për riatdhesim \(CPR\)?](#)

- Nëse dërgoheni në këtë qendër menjëherë pas daljes suaj nga burgju, **maksimumiqë mund t'ju mbajnë aty është deri në 45 ditë.**
- Nëse ju japin përjashtim nga vendi, mbasi ju keni mbaruar burgun dhe ndodheni jashtë i lirë, mund t'ju mbajnë brenda kësaj qendre për 30 ditë, me një kohëzgjatjederi në 90 ditë.
- Në të rastet (45 ditë ose 90 ditë), **për personat me origjinë nga disa vende të percaktuar** (nuk specifikohet cilat shtete) **mund të jetë e parashikuar një periudhë në qendrën e riatdhesimit më shumë se 30 ditë (në përgjithësi deri në 120 ditë).**

## NDALIMI I HYRJES NË SHTETIN ITALIAN

Nëse jeni përjashtuar nga shteti italian, nuk mund të hyni më në Itali, po ashtu edhe në shtetet e tjera që bëjnë pjesë në Bashkimin Evropian.

### [? Çfarë ndodh nëse hyni në Itali pa këtë autorizim?](#)

- Mund të dënoheni me vuajtje dënimi me burg nga 1 deri në 4 vjet;
- Do të përjashtoheni nga vendi dhe do t'ju shoqërojnë menjëherë në kufi;
- Nëse, pasi keni marre dy herë përjashtim nga territori, ktheheni përsëri në Italinë mënyrë të paligjshme, mund të dënoheni me vuajtje dënimi me burg nga 1 deri në 5 vjet.

? Sa kohë zgjatë ndalimi për tu kthyer prap në Itali, pas ndëshkimit me përjashtim nga vendi?

- **Zakonishtë, jo më pak se 3 vjet dhe jo më shumë se 5 vjet;**
- Mund të zgjasë më shumë se 5 vjet, nëse ju bëni pjesë në një nga kategoritë e parashtruar nga ligji: personat e konsideruar te rrezikshëm për shoqërinë të cilët kanë kryer krime të rënda si për shembull akte terroriste.

? Nëse ktheheni në shtetin tuaj dhe jeni akoma i pandehur apo i ofenduar në një proces gjyqësor që po zhvillohet në Itali a mund të kthehet për të marrë pjesë në të?

Nëse ju kanë thirrur për një datë të seancës që do të zhvillohet, duhet të kërkonti komisaritatit, personalisht ose nëpërmjet avokatit, një **autorizim** për të hyrë në shtetin italian. Ky autorizim do të lëshohet nëpërmjet Konsullatës ose Ambasadës Italiane në shtetin tuaj të origjinës.

### **3.4. PËRJASHTIMI I MINISTRISË SË BRENDSHME (NENI. 13 PAR. 1 T.U.I.)**

Është shumë e rrallë dhe mund të merret ky vendim vetëm për arsye të rendit publik dhe të sigurisë së shtetit ose për arsye të parashikimit dhe të parandalimit të aktëve terroriste. Nëse është marrë ky vendim, flisni menjëherë me një avokat, sepse ky tip vendimi për përjashtim nga shteti italian hyn në fuqi menjëherë, dhe në mënyrë të menjëhershme do t'ju shoqërojnë në kufi.

### **3.5. RASTET KUR PËRJASHTIMI ËSHTË I NDALUAR (NENI. 19 T.U.I.)**

Ajo që kemi parë deri tani është e vërtetë në përgjithësi megjithatë, ka disa raste kur NUK MUND të **përjashtoheni nga vendi italian**:

- a) **Kur, në shtetin tuaj ekziston rreziku i përsekutimit** për shkaqe rraziale, seksi, gjuhe, shtetësie, fetare, për opinion politik, të situatës suaj personale dhe shoqërore (edhe pse nuk keni bërë kërkesë për azil);

- b) Nëse në shtetin tuaj rrezikoni t'ju nënshtroheni torturave ose keqtrajtimeve çnjerëzore (për të vlerësuar këto shkaqe merren parasysh dhe shkeljet e përhapura e të drejtave të njeriut në shtetin tuaj të origjinës);
- c) Kur përjashtimi nga territori nënkupton cënimin e të drejtës suaj për jetën private dhe familjare
- d) Kjo do të thotë kur **jeta juaj i ka rrënjët ne shtetin italian, sepse keni lidhje familjare në Itali ose sepse keni jetuar dhe punuar për shumë kohë në këtë vend**, etj etj., nuk mund të përjashtoheni nga shteti italian;
- e) Kur bashkëjetojnë me të afërm deri në shkallën e dytë (prindër, fëmijë, vëlla/motër) ose me bashkëshort, me nënshtetësi italiane.

**KUJDES:** duhet të vërtetoni bashkëjetesën tuaj (me çertifikatë familjare ose dokumenta të tjera);

- kur jeni në shtatzënë dhe deri në gjashtë muaj pas lindjes së fëmijës;
- kur jeni i Ati (babai) i fëmijës në pritje të lindjes dhe në gjashtë muajt pas lindjes së fëmijës;
- Nëse kushtet tuaja të shëndetit janë të rënda dhe nuk mund të kuroheni në shtetin tuaj.

**KUJDES!** Nëse ekzistojnë rreziqe për arsye shtetërore ose më saktë të Rendit dhe sigurisë publike (për shembull keni kryer vepra penale shumë të rënda), prefektura gjithësesi mund të vendosë t'ju largojë POR duhet marrë parasysh lidhjet tuaja familjare dhe jetën tuaj private në Itali: **përjashtimi nga territori nuk zbatohet automatikisht.**

Në rastet e ndalimit të përjashtimit nga vendi, ju keni të drejtë të keni një leje qëndrimi për mbrojtje të veçantë (rasti a dhe b), për arsye familjare (rasti d), për kurime mjekësore (rasti e, f, g).

<p><b>ËSHTË E RËNDËSISHME</b></p>	<p>Nëse nuk hyni në rastet e treguar më sipër, por keni <b>keni pësuar dhunë fizike (dëmtime të trupit tuaj), psikologjike, seksuale, ose jeni në kurim për problemet e shëndetit fizik ose mendor</b>, takohuni dhe flisni me avokatin tuaj ose me një edukator sepse situata juaj është e PAPËRSHTATSHME me përjashtim nga vendi dhe me <b>qëndrimin në qendrën e mbajtjes për riatdhesim (CPR).</b></p> <p>Nëse nuk mund të përjashtoheni nga shteti italian NUK mund t’ju mbajnë as në qendrën riatdhesimit: <u><b>nëse ndodheni në këtë qendër, komunikoni me avokatin tuaj ose me Garantin e të burgosurve për ta informuar se në rastin tuaj është i ndaluar përjashtimi nga territori italian.</b></u></p>
---	--

### 3.6. RIATDHESIMI VULLNETAR OSE ME SHOQËRIM

Është një program për kthimin përfundimtar në vendin e origjinës tuaj, për të pasur ndihmë për të nisur projektin e jetës suaj.

Kujdes, nuk hyni në këtë program nëse:

- Keni marrë një ndëshkim me përjashtim nga vendi, nga një vendim nga Ministria (neni. 13 par. 1 T.U.I.);
- Keni marrë një paralajmërim për përjashtim nga territori për rrezikshmëri sociale (neni. 13 par. 2 leximi. c) T.U.I.);
- Keni marrë një paralajmërim për përjashtim nga territori si përmasë sigurie (neni. 15 T.U.I.);
- Keni marrë një paralajmërim për përjashtim nga territori si përmasë alternative (të ndryshme).

## Kapitulli IV. PËRFITIME NË BURG

### PARATHËNIE

Gjatë kohës që ju po kryeni dënimin mund të kenë akses në përfitime të ndryshme, të cilat janë, mundësia që të dilni me leje, të punoni si brenda dhe jashtë burgut, dhe mundësi dhënie të përmasave alternative të paraburgimit. Këtu po ju PARAQESIM DISA përfitime të ndryshme; për të patur më shumë informacione mbi këtë argument, konsulloheni tek të “Udhëzues për personin e privuar nga liria personale”, që flet për jetën e përditshme në institutin e burgut. Udhëzuesi është në dispozicion në gjuhën italiane, anglisht, frengjisht dhe arabisht.

Si mund të merrën këto përfitime? mund ti kërkon drejtpërdrejt ose mund të kërkon ndihmë një edukatori, ose mund ti kërkon ndihmë avokatit tuaj. Mbi kete kërkesë vendos Gjykatesi i Mbikëqyrjes ose Gjykata e Mbikëqyrjes. Nëse nuk e konsideroni të saktë vendimin Gjykatës, mund të paraqisni një ankesë: për këtë, duhet ti drejtoheni avokati tuaj.

### KUJDES!

#### LIMITE PËR MARRJEN E PËRFITIMËVE – DËNIME TË VEÇANTA (neni. 4 bis OP)

Nëse keni kryer një krim që bën pjesë tek neni 4 bis në ordinamentin e burgut, për të marrë përfitimet është më e vështirë. Në disa raste, nuk ju pranohen përfitimet ose ndoshta mund t’ju kërkojnë kërkesa shtesë.

Nëse ju jeni i akuzuar me një dënim që hyni tek **neni 4 bis par. 1 o.p. (për shëmbull i denuar për vepra penale që futen tek terrorizmi, për krimet në organizatë kriminale për trafik droge, trafik i qenjes njerëzore e të tjera)**. Përfitimet në këtë rast janë të limituar.

Në përgjithësi, për të patur përfitime, duhet të keni bashkëpunoni me drejtësinë (ose të provoni se bashkëpunimi është e pamundëshme dhe i kotë) **dhe sidoqofte, duhet verifikuar që nuk ekzistojnë lidhje me organizatat kriminale me të cilat bënit pjesë, dhe që nuk do të keni kontakte edhe në të ardhme.**

## 4.1. LEJA SI ÇMIM I PËRFITUESHËM

Është një leje e cila ju lejon të kultivoni interesa: kulturore, ndjenjësore dhe punësimi (p.sh. mund të vizitoni familjarët tuaj, të kryeni aktivitete në lidhje me punën tuaj etj.).

**KUJDES!** Nëse ju i plotësoni kushtet për të kërkuar këtë leje, por nuk keni familjarë afër ose nuk njihni një vend të përshtatshëm ku mund të kryeni ditët e lejes, **kërkoni informacion edukatorit tuaj, vullnetarëve ose zyrës së Garantit për të drejtat e të burgosurve.**

Leja e përfituar mund të lëshohet nga Gjyqtari i mbikqyrjes së burgut, që mund t'ju lëshohet deri në 15 ditë rresht, por jo më shumë, dhe ka **një maksimum prej 45 ditësh** për çdo vit të dënimit.

**?** [Kur është e mundur të marrësh lejen e përfituar?](#)

Mund të merrni këtë përfitim vetëm nëse jeni i denuar në formë përfundimtare dhe keni kryer dënimin në mënyrë të rregullt (do të thotë që **keni treguar sjellje të përgjigjshme dhe korrekte**) në burg dhe kur nuk jeni i konsideruar si i rrezikshëm për shoqërinë.

Nëse duhet të vuani dënimin për një kohë më pak se **4 vjet**, mund ta kërkonti menjëherë lejen. Për dënimet që janë më shumë se 4 vjet, duhet të kalojë një farë kohe e duhur. Në veçanti mund të kërkonti lejen NËSE:

- Jeni dënuar më shumë se **4 vjet dhe keni kryer të paktën  $\frac{1}{4}$  e dënimit**. (p.sh. nëse dënimi juaj është 16 vjet me heqje lirie, për të përfutur lejen, duhet të keni kaluar të paktën 4 vjet në burg):
- Jeni dënuar se keni kryer veprën penale që bën pjesë tek neni. 4 BIS o.p. dhe keni kryer të **paktën gjysmën e dënimit (ose të paktën 10 vjet)**;
- Jeni të dënuar me burg të përjetshëm (ergastolo) dhe keni kryer të paktën 10 vjet në burg.

**KUJDES!** Nëse keni kryer një vepër penale gjatë vuajtjes së dënimit, duhen të kalojnë të **paktën 2 vjet nga ngjarja** për të kërkuar lejen. Nëse keni kryer vepër penale që përshikon neni 4 bis, për të cilën parashikohet një dënim 3 vjeçarë ose më shumë se 3 vjet, nuk mund të kërkonti leje deri sa të **bëni 5 vjet**.

**KUJDES!** Nëse hyni me vonesë nga leja e dhënë, mund të merrni një sanksion disiplinor dhe, nëse vonesa është më e lartë se dymbëdhjetë orë, do të denoncohet për shkak të shkeljes së evazionit/ arratisjes nga vuajtja e dënimit.

## 4.2. LEJA PËR NEVOJAT PERSONALE

Kjo lloj leje mund të jepet edhe pse nuk jeni i dënuar me dënim përfundimtar. Leja lëshohet për arsyet **ku një nga familjarët tuaj ose bashkjetues-ja/i juaj ka probleme të rënda shëndetësore (rrezikon jetën)**. Leja i kërkohet Gjyqtarit të Mbikëqyrjes së burgut dhe është e nevojshme të **vërtetoni lidhjen e afërt me njeriun e sëmurë** bashkangjitur me dëshminë që përsori rrezikon humbjen e jetës.

Leja duhet ti kërkohet:

- Gjyqtarit të mbikëqyrjes së burgut, kur keni marrë dënim përfundimtarë:
- Gjyqtarit të çështjes (p.sh. Gjyqtarit të akuzave të shkallës së parë të gjykatës, Gjyqtarit të shkallës së Apelit, nëse procesi është në vazhdim.)

Dhënja e lejes vlerësohet për çdo rast, dhe jepet edhe për arsye të tjera familjare (p.sh. mund të jepet për arsye të lindjes së fëmijës tuaj).

### 4.3. PUNË BREnda BURGUT

Ndërkohë që jeni në burg mund t'ju jepet mundësia të **punoni për burgun ose për punëdhënësit që punojnë brenda në Institut.**

Për shkak të vendeve të pakta për punësim, shpërndarja e punës bëhet kryesisht me rotacion dhe me periudha të shkurtra. Kërkoni informacione nëpërmjet edukatorit tuaj.

### 4.4. PUNËSIMI JASHTË BURGUT

(**Neni 21 OP**) ky lloj përfitimi ju jep mundësinë të punoni jashtë burgut. Kjo përmasë sigurie jepet nga Drejtoria e institutit të burgut, me aprovim të Gjyqtarit të mbikqyrjes së burgut.

**KUJDES!** Nëse ndodheni në burg për veprën penale të parashikuar në nenin 4 bis o.p., mund të filloni punë jashtë vetëm nëse:

- Keni kryer **një të tretën  $\frac{1}{3}$  e vuajtjes së dënimit**, ose të paktën 5 vjet.
- Keni kryer **të paktën 10 vjet** për vuajtjen e dënimit që parashikon dënim të përjetëshëm (**ergastolo**).

<b>ËSHTË E RËNDËSISHME</b>	Mund të punësoheni si brenda dhe jashtë burgut <b>EDHE pse NUK keni leje qëndrimi, ose ju ka skaduar leja e qëndrimit .</b>
----------------------------	---

### 4.5. LIRIMI I PARAKOHSHËM

Është një **ulje dënimi, që parashikon 45 ditë në çdo 6 muaj të vuajtjes së dënimit.** Futet në llogari edhe koha e paraburgimit si në burg edhe në arrest shtëpie, arresti i shtëpisë, edhe besim-dhënia (affidamento) që Gjykatësi ju ka pranuar.

NUK ka limit dënimi. Ndër të tjera, lirimi i parakohshëm përfshin të gjithë të dënuarit që kanë të bëjnë me çdo vepër penale, edhe atyre që i parashikon neni. 4 bis o.p.

<p><b>ËSHTË E RËNDËSISHME</b></p>	<p>Lirimi i parakohshëm i njihet atyre që kanë patur <b>sjellje të mirë</b> gjatë kryerjes së dënimit në Institut të burgut, por kjo duhet të shoqërohet edhe me <b>pjesmarrje aktive të trajtimit riedukativ (mbi këtë aspekt kërkoni informacione edukatorit tuaj).</b></p>
-----------------------------------	---

**Nëse jeni dënuar me burg të përjetshëm (ergastolo),** mirësjellja dhe pjesmarrjet në projektin riedukativ ju lejojnë gjithësesi të përfitoni lirin e parakohshëm. 45 ditët e dhëna në çdo 6 muaj, konsiderohen si kryerje e vuajtjes së dënimit: në këtë mënyrë ju mund të përshpejtoni kërkimin e lejes si çmim i përfituar.

Për të marrë lirin e parakohshëm, **ju duhet të bëni një kërkesë me shkrim Gjyqtarit të vëzhgimit të burgut.** Kërkesa duhet të përmbajë disa të dhëna (kërkoni ndihmë edukatorit tuaj):

- të dhënat tuaja; nëse po kryeni dënimin në burg ose në mënyrë të ndryshme nga ajo me burgim, si me arrest shtëpie etj., (kështu shpjegoni mënyrën e burgimit); të dhënat e seancës (p.sh. numrin dhe datën të autoritetit gjyqësor që ka vendosur). Edhe nëse nuk njihni këto të dhëna mund ta prezentoni njësoj kërkesën.
- Gjashtë mujorshi kur kërkoni ditët ose përfitimin e uljes së vuajtjes së dënimit, me data e fillimit dhe te perfundimit te semestrit.
- Vendin përkatës së vuajtjes së dënimit.

Gjyqtari do të vendosë nëse mund t’ju japë vendimin për lirin e parakohshëm **duke u bazuar nga një raport mbi sjelljen tuaj brenda institutit.**

**KUJDES!** Lirimi i parakohshëm mund dhe të mos ju njihet nëse keni kryer vepër penale gjatë ekzekutimit të vujtjes së dënimit. Kjo do të thotë që mund t’ju a heqin prap ditët që ke marë.

## **4.6. MIRËBESIMI NË PROVË NË SHËRBIMËT SHOQËRORE (shërbime sociale) - (Affidamento in prova)**

Mirëbesimi në provë të shërbimeve sociale është një formë dënimi i ndryshëm nga ai me burg, është një përfitim që ju jepet për të bërë dënimin jashtë burgut, duke ndjekur një program i cili është rënë dakord me zyrën e ekzekucionit penale jashtë burgut (U.E.P.E.).

Mund të mbështeteni te mirëbesimi nëse keni nje dënim më **PAK SE 4 VJET.**

**Kjo përmasë mund të përfitohet në bazë të një kërkesë me shkrim i drejtuar Gjykatës sëvëzhgimit të burgut**, e cila do ju fiksojë një seancë, ku do të vendoset nëse mund t'ju jepet e drejta e ndryshimit të përmasës, nga denimi me burg në mirëbesim në provë të shërbimëve sociale, duke treguar gjithashtu aktivitetet që duhet të kryhen gjatë mirëbesimit. Në këtë seance mund të marrë pjesë avokati juaj ose nëse nuk keni një avokat, do të emërohet avokati i zyrës.

### **Rastet e veçanta (përsonat me dipendencë) – (vese)**

Nëse keni varësi (dipendenza) nga alkoli, nga lëndët narkotike, mund të bëni pjesë në programin e mirëbesimit të provës (affidamento in prova) kur:

- Dënimi që ju po vuani është më pak se 6 vjet (ose 4 vjet në rastet kur dënimi përmban nenin 4 bis) E
- Keni nisur që të bini dakord në një program për tu kuruar (rënë dakord me SERD dhe të ASL tuaj (ASL: Agjensia Shëndetësore Lokale): nëse nuk dini si të bëni, kërkoni ndihmë edukatorit tuaj.

Kur të bëni kërkesë, **duhet të bashkangjisni** programin e terapisë dhe një dokument që vërteton (çertifikatë) gjëndjen tuaj të varësisë.

**KUJDES!** kjo përmasë mund të jetë e **PEZULLUAR OSE MUND T'JU HIQET DHE MOS T'JU PRANOHET:**

Kur jeni në mirëbesim për persona me varësi, duhet ti nënshtroheni kontrolleve të përkoheshme: nëse rezultoni si përdorues i alkolit dhe i lëndëve narkotike, **është e mundëshme që përmasa e mirëbesimit në provë mund t'ju hiqet.**

Mirëbesimi në provë në përgjithësi, mund t'ju pezullojnë ose t'ju heqin nëse:

- Gjatë periudhës së ndjekes së këtij programi, ju vjen një tjetër **vendim me burg në formë përfundimtare ku kalon limitin e 4 viteve;**
- nëse keni shkelur rregullat (detyrimet dhe ndalimet që ju janë imponuar) dhe keni vepruar në kundërshtim me ligjin.

Në këto raste, Gjykata e Mbikqyrjes do të caktojë një seancë gjyqësore për të vendosur nëse do të revokojë përmasën, duke kontaktuar menjëherë avokatin e saj.

<p><b>ËSHTË E RËNDËSISHME</b></p>	<p>Mund të pranoheni për mirëbesim në provë dhe për të kryer programin e vendosur nga UEPE EDHE nëse nuk keni pasur asnjëherë leje qëndrimi ose lejae juaj ka skaduar.</p> <p>Mund të viheni në mirëbesim në provë për të punuar dhe për të ndjekur programin që është vendosur nga Uepe EDHE pse nuk keni leje qëndrimi ose ju ka skaduar.</p> <p><b>Gjatë mirëbesimit në provë është e mundëshme që të punësoheni, edhe pse jeni pa leje qëndrimi.</b></p>
---	--

## 4.7. ARRESTI I SHTËPISË

Arrestimi i shtëpisë është një përmasë sigurie e ndryshme nga ajo me burg (alternative), që ju lejon të vuani dënimin e parashikuar jashtë burgut, por **brenda një vendi të percaktuar, i cili mund të jetë shtëpia juaj, ose një godinë e shërbimeve sociale.**

**Kjo përmasë duhet ti kërkohet me shkrim Gjykatës se vëzhgimit të burgut,** e cila do të fiksojë një seancë ku do vendosin nëse do ta japin përmasën apo jo. Nëse nuk keni një avokat personal të besuar, do të emërohet një avokat zyre.

**Arrestimi i shtëpisë ordiner:** ju mund të përfitoni arrest në shtëpi kur dënimi në të cilin jeni dënuar ose që ju mbetet për t'u kryer është më pak se 4 vjet, nëse:

- jeni një grua shtatzënë ose nënë e fëmijëve nën moshën dhjetë vjeçare (nëse keni përgjegjësi prindërore mbi ta);
- jeni babai i fëmijëve nën moshën dhjetë vjeç, nëse keni përgjegjësi prindërore dhe nëna nuk mund të kujdeset për ta;
- jeni një person në gjendje të rëndë shëndetësore që kërkon kujdes të vazhdueshëm që nuk mund të kryhet në burg (p.sh. nëse duhet të nënshkruajë transfuzione; nëse ka kontraktuar HIV); jeni mbi 60 vjeç dhe nuk jeni në gjendje të kujdeseni për veten, madje vetëm pjesërisht

- jeni nën moshën 21 vjeç dhe keni nevoja të dëshmuara shëndetësore, studimi, pune dhe familje.

**Arrest në shtëpi si formë gjenerike:** mund ti nënshtrohesh kësaj forme të përmasës në arrest shtëpie EDHE kur dënimi është në pritje të vujtjes ose është më pak se 2 vjet, nëse:

- Nuk janë përdorur kushtet për mirëbesim në provë tek shërbimet sociale;
- Jeni sjellur mirë brënda institutit të burgut;
- Nuk keni kryer vepra penale të rëndë si ato që parashikohen në Nenin. 4 bis par. 1 (p.sh. **bashkëpunim në organizatat kriminale mafioze, peng marrje personi me qëllim për përfitime, trafik të lëndëve narkotike, vepra penale të konsideruar terroriste**).

**Arrest shtëpie në formë speciale:** mund të keni këtë përmasë sigurie nëse jeni **nëna e fëmijëve nën moshën 10 vjeçare** dhe keni vuajtur  $\frac{1}{3}$  e dënimit. Nëse jeni dënuar me burg të përjetshëm (ergastolo) duhet të keni bërë të paktën 15 vjet burg.

**Mund të keni këtë përmasë sigurie edhe nëse jeni babai i fëmijëve nën moshën 10 vjeçare**, kur mamaja e fëmijëve nuk jeton më, ose është e pamundur që ajo tju rri afër dhe të kujdeset për fëmijët e saj (kështu jeni i vetëm që kujdeseni (tutor) për fëmijët tuaj).

**Arrest shtëpie për arsye shëndeti:** Është e mundur të merrni përmasën e arrestit të shtëpisë edhe kur është parashikuar **shtyrja e detyrueshme dhe opsionale** e dënimit

- **Shtyrja është e detyruar** në rastin kur gruaja është shtatëzënë, grua e cila ka gjashtë muaj që ka lindur ose persona me sëmundje të HIV (kur burgimi nuk është i pamundur për shkak të sëmundjes së rëndë).
- **Shtyrja është jo e detyrueshme/opsional** në rastet e prezantimit të kërkesës për falje, gjëndje e rëndë e shëndetit në sëmundje fizike dhe të grave të cilat kanë më shumë se 6 muaj që kanë lindur, ku fëmija nuk mund ti besohet ndokujt tjetër përveç të ëmës.

**KUJDES!** Kjo përmasë sigurie mund të **PEZULLOHET OSE MUND TË TËRHIQET:**

- Nëse kryeni veprime në kundërshtimin me ligjin ose me parashikimet e Gjykatës së vëzhgimit të burgut, dhe që janë të pa pranueshme me rregullat e parashikuara të masës së sigurisë;

- Nëse jeni i dënoncuar/paditur për arratisje;
- Nëse shërbimet sociale informojnë Gjykatësin e vëzhgimit të burgut që kushtet për arrestin e shtëpisë nuk plotësohen.

## 4.8 GJYSMË-LIRIA (SEMILIBERTA’)

Është një përmasë që ju lejon të kaloni një pjesë të ditës jashtë burgut për të punuar, për të marrë pjesë në kurset e arsimit ose të trajnimit profesional ose për të kryer aktivitete të dobishme për reintegrimin social (si vullnetarizmi). Mund të jepet kur ka pasur përparime të mira në rrugën e riedukimit dhe besohet se i denuari mund të kthehet gradualisht në shoqëri, sepse nuk ka rrezik që të kryejë krime të reja.

Nëse dënimi i tij me për tu shlyer është më pak se katër vjet, ai mund të kërkojë përmasën menjehere. Nëse ka ende për të kryer një dënim prej më shumë se katër vjetësh, i denuari mund të pyesë nëse ka shlyer të paktën gjysmën e dënimit të përgjithshëm (dhe dy të tretat në rastin e veprave të përmendura në nenin 4a). Nëse ai është i dënuar me burgim të përhershëm, mund të kërkohet pas 20 vjetësh. Përmasat kërkojnë dhe vendosen nga Gjykata e Mbikqyrjes pas një séance në të cilën merr pjesë avokati i emëruar ose, nëse është emëruar një avokat, do të emërohet një avokat zyre.

**KUJDES!** Si mirëbesimi në provë, gjysmë-liria mund të pezullohet dhe/ose të tërhiqet nëse i denuari:

- Nuk plotëson detyrimet që i janë imponuar dhe nuk angazhohet mjaftueshëm nëpër aktivitete;
- Nëse gjatë përmasës bëhet përfundimtar një dënim tjetër me një dënim që, i shtuar me atë që është duke u zbatuar, tejkalon kufirin e dënimit.

## Kapitulli V. TAKIMET

### 5.1. TAKIMET NË PREZENCË

Ju mund të jeni i autorizuar që të bëni takime me familjarët tuaj ose persona të tjerë. Familjarët janë: bashkëshorti; bashkëjetuesi; të afërmit deri në shkallën e katërt. “Personë të tretë” i referohet personave të tjerë, përveç të afërmeve, të cilët kanë një arsye të mirë për t’u takuar me të burgosurit. Ju mund të bëni:

- 6 takime në muaj, nëse ndodheni në burg sepse keni kryer vepra penale të zakonshme;
- 4 takime në muaj, nëse ndodheni në burg sepse keni kryer vepra penale që parashikon nenin 4 bis par. 1 O.P.

**Çdo takim zgjat 1 orë, por është e mundur në disa raste të zgjatet deri në 2 orë.**

Takimet bëhen në vëzhgim të policisë së burgut. Por policia nuk mund të dëgjojë bisedimet me familjarët tuaj.

<b>ËSHTË E RËNDËSISHME</b>	<b><u>Takimet me fëmijët në raste të veçanta:</u></b> kur një vendim nga Gjykata për të miturit ju ka kufizuar përgjegjësinë prindërore, ose ose ka një procedurë në vazhdim që ka të bëjë me përgjegjësinë prindërore > mund të bëni takim me fëmijët në një dhomë të veçantë të institutit (nëse keni autorizimin e Gjykatësit).
------------------------------------	--

#### ? Kujt i kërkohet autorizimi?

Për të bërë një takim është e nevojshme të jeni i **autorizuar**. Autorizimi lëshohet nga:

- Drejtori i institutit të burgut kur ju jeni denuar, në procesin e shkallës së parë;
- Gjyqtari i Gjykatës kur ju jeni akoma në pritje të procesit të shkallës së parë.

#### ? Cfarë dokumentash nevojiten?

Duhet si gjithmonë dokumentat e të dhënave personale (p.sh. kartë identiteti, leja e qëndrimit, pashaportë). Në disa raste është e mjaftueshme edhe një deklaratë me shkrim e firmosur nga familjari juaj, në të tjera raste është e nevojshme një dokument i lëshuar nga konsullata e vendit tuaj.

**KUJDES!** Do të bëhen kontrole mbi dokumentat e deklaramit. **Të deklarojsh të pavërtetën është vepër penale** dhe mund të akuzoheni për mashtrim dhe për deklarimet fallsifikuar.

### **Bashkëshorti/ja dhe familjarët me shtetësi italiane ose qytetar të Bashkimit Evropian**

1. Dokument i identifikimit të vleshëm;
2. **Vetë-deklarim** për sa i përket afërsisë dhe lidhjes familjare me të dënuarin.

### **Bashkëshorti/ja dhe familjarë që nuk bëjnë pjesë në Bashkimit Evropian**

1. Dokument identifikimi (leje qëndrimi, pashaportë) të vleshëm në momentin e takimit;
2. Dokumentet që ju lëshohet nga konsullata e vendit tuaj, **që të jetë i përkthyer në italisht, ku rezulton dhe tregon që janë familjarët tuaj.**

**KUJDES!** Nëse bashkëshorti/ja ose anëtari i familjes është i huaj, **por ka një vendbanim/rezidence në Itali**, dhe marrëdhënia e martesës / prindërimit rezulton nga dokumente të njohura nga zyrat e Administrimit të burgut, është i mjaftueshëm vetëm një vetë-çertifikimi (p.sh. nëse keni qenë i martuar ose i regjistruar në Itali, vetë-çertifikimi është i mjaftueshëm).

### **Bashkëjetuesi është italian ose qytetar i Bashkimit Evropian**

1. Dokument identifikimi i vleshëm;
2. Një çertifikatë që vërteton bashkëjetesën tuaj ose çertifikatë familjare.

### **Bashkëjetuesi është i huaj që nuk bën pjesë në Bashkimin Evropian**

1. Dokument identifikimi (leje qëndrimi, pashaportë) të vleshëm në atë moment;
2. Çertifikatë banimi në Itali ku bashkëjetonit deri në momentin e arrestimit tuaj;
3. Nëse bashkëjetesa bëhet jashtë vendit, duhet një çertifikatë ose vërtetim nga konsullata e vendit tuaj të origjinës, ose çertifikatë e lëshuar nga një shtet i huaj tjetër ku është kryer bashkëjetesa që vërteton marrëdhënien tuaj. Dokumentat duhen të jenë të përkthyer në gjuhën italiane.

## Personat e tretë (miqtë)

1. Dokument identifikimi i vlefshëm (nëse nuk jeni shtetas Evropian: leje qëndrimi – permesso di soggiorno – ose pashaportë);
2. Një certifikatë që deklaron që personi nuk ka probleme me shtetin, dhe nuk ka dënime për të bërë ose është vendosur në ndonjë përmasë e përshkruar nga autoritetet e shtetit.

**KUJDES!** Para se të fillojë takimi, personi që do të vijë t’ju takojë, do të kontrollohet si nga dokumentat, për të parë nëse janë në rregull, por edhe fizikisht (**kontroll personal**): personat që ju vijnë për t’ju vizituar, duhet të lënë sendet personale në vendet përkatëse të kujdesuar nga policia e burgut, dhe mund ti marrin në momentin e përfundimit të vizitës, në momentin e daljes.

## 5.2. TELEFONATAT (takimet zanore)

Ju mund të jeni i autorizuar për të bërë telefonata me familjarët, me bashkëjetuesit, dhe me persona të tjerë, nëse kane motive të arsyetueshëm (terzapersona).

### ? Kujt i kërkohet autorizimi?

- Nëse jeni i akuzuar dhe jeni në pritje të një proçesi në shkallë të parë, leja ose autorizimi i telefonatave lëshohet nga autoriteti i palës akuzuese nga Prokurori (Pubblico Ministero);
- Nëse keni marrë dënim në shkallën e parë, autorizimi i telefonatave do të lëshohet nga Drejtoria e Institutit.

### ? Sa telefonata mund të bëni?

Nëse jeni i burgosur si kryes i një vepre penale të zakonshme, **mund të bëni një telefonat në javë e cila zgjat 10 minuta**. Nëse keni kryer vepër penale që parashikon nenin. 4 bis në këtë rastë do të keni **2 telefonata në muaj** që zgjasin 10 minuta për çdo telefonat.

Mundet edhe të autorizoheni për të pasur më shumë telefonata nëse kërkoni të flisni me fëmijët tuaj, kjo mund të bëhet kur fëmijët janë nën moshën 10 vjeçare, ose kur keni pak kohë që jeni transferuar nga një burg tjetër (telefonata straordinaria).

## ? Si funksionon shërbimi?

Nëse dëshironi të telefononi, duhet të bëni **kërkesë me shkrim** autoritetit të institucionit (Drejtorit të burgut ose autoritetëve gjyqësore), ku ju kërkoni dhe tregoni numrat e telefonatave të **njerëzëve me të cilët do flasësh** (shiko poshtë).

**KUJDES!** Telefonatat bëhen me shpenzimet e tuaja. Në institut është e mundur **blerja e një skede telefoni** me mundësi rimbushje lekësh me të cilën mund të bëni telefonatat. Nëse nuk keni parà për të telefonuar, provoni ti kërkoni ndihmë edukatorit tuaj, priftit ose vullnetarëve.

## TELEFONATA ME NUMËR CELULARI

Është e mundur të telefononi me numër celulari, kur nuk ka mënyra të tjera për të komunikuar ose për tu vënë në kontakt me familjarët, bashkëjetuesit dhe me persona të tjerë.

- Nëse jeni shtetas Evropian dhe doni të përdorni celularin si mjet komunikimi, **duhet të dorëzoni një vetë-vërtetim kur tregoni afërsinë dhe lidhjen tuaj familjare**, dhe duhet të dërgoni edhe një kopje të kontratës së skedës SIM.
- Nëse jeni SHTETAS JO EVROPIAN (i huaj) duhet të dorëzoni një dokument të konsullatës që tregon afërsinë familjare si dhe dorëzimin e një kopje të kontratës së mumrit SIM të personit që do kontaktoni, edhe nëse personi me të cilin do flisni ndodhet jashtë Italisë.

## SHËRBIMI I POSTËS ELETRONIKE

Mund të shfrytëzoni **shërbimin me abonim të Zero mail** (përkujdesur nga kooperativa Zero Grafika), me shpenzimet e tuaja. Ky shërbim ju lejon të dërgoni dhe të merrni mail. Mund të bëni kërkesë për të shfrytëzuar këtë shërbim duke ju drejtuar Zyrës së kërkesave (l'Ufficio Comando) që i përket sezionit ku ti ndodhesh. Tek Zyra mund të kërkoni formularin për ta plotësuar ku bën të mundur të drejtën e këtij shërbimi.

## Kapitulli VI. BURGU I RËNDË – siguria e lartë - (Neni 41 bis O.P.)

Rregullat e “burgut të rëndë” janë rregulla të veçanta dhe shumë të ashpra, të cilat ju jepen personave me rrezikshmëri të lartë për rendin dhe sigurisë publike dhe kur ju keni kryer nje vepër penale e parashikuar nga neni 41 bis (i cili kujton nenin. 4 bis o.p.). Për shembull, ato përfshijnë: krimet e kryera me qëllim terrorizmi ose me qëllim shkatërrimi te rendit demokratik; shoqata mafioze ose krimet e kryera për të lehtësuar një shoqatë mafioze ose sipas metodës mafioze.

### ? Çfarë përmasash sigurie mund t'i zbatohen?

- **Izolim** nga të burgosurit e tjerë. **Nuk mund të keni marrdhënie me të burgosur të tjerë** të cilët nuk janë në të njëjtin pozicion që mund të keni ju. Do te jeni gjithmonë **në vëzhgim të vazhdueshëm** ;
- Do të ketë kontroll nën vëzhgim të postës së daljes dhe hyrjes dhe do te keni një kufizim të shumave, mallrave dhe sendeve që mund të merrni nga jashtë (p.sh. robot dhe ushqimi);
- Do të ketë kufizime në biseda. Në veçanti:

### TAKIMET NË PREZENCË

- **Ju mund të bëni vetëm një takim në muaj**, me rregullat e kohës së caktuar nga burgu dhe në dhoma të sistemuara për vëzhgim nga telekamerat edhe nga policët e burgut, në mënyrë që të shikojnë dhe të kontrollojnë që të shmanget shkëmbimi i objekteve si në hyrje dhe në dalje. Vizitat do të jenë të ndara nëpërmjet një xhami, kështu ju nuk mund të keni kontakt fizik me familjarët tuaj, (mund të bëni takim pa xham vetëm në raste kur mund te vijnë fëmijët ose nipërat që janë poshtë moshës 12 vjeçare);
- **Ju mund të takoni vetëm familjarët më të afërt, si personin që jeni martuar ose personin me të cilin bashkëjetoni** (mund të jenë disa përjashtime që do të vlerësohen rast pas rasti);
- Takimet janë të kontrolluara dhe të regjistruara me video.

## BISEDAT TELEFONIKE

Nëse nuk bëni takim në prezencë, të paktën mbas 6 muajsh që ndodhesh në burg të ashpër, mund të kërkonte një telefonatë në muaj, por:

- Vetëm me familjarët me të afërm, bashkëshortin/en ose bashkëjetuesi/ja
- Telefonata mund të zgjase deri në 10 minuta
- Telefonata e juaj do të regjistrohet.

**AVOKATI MBROJTËS:** mund të keni biseda javore me mbrojtësin tuaj si në takim me prezencë po ashtu edhe me telefon.

**GARANTI:** Mund të keni gjithmonë takime me Garantin, pa asnjë kufizim. Mund të bëni gjithsesi takimin tuaj mujor me të afërmit edhe nëse keni bërë takim me Garantin. Takimet me Garantin nuk ju pengojnë tek takimet mujorshe që keni me familjarët e tuaj.

## Kapitulli VII. TRASFERIMI NË NJË SHTET TJETËR, ANËTAR TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË KRYER VUAJTEN E DËNIMIT/SHLYER DËNIMIN

**KUIDES!** Kjo mundësi ekziston vetëm për **qytetarët e shteteve të Bashkimit Evropian** ose për qytetarët e shteteve të treta (jashtë BE-së) **që kanë rezidencë banimi** në një shtet tjetër të BE-së.

### ? Trasferimi: për çfarë bëhet ?

Personat e burgosur që janë qytetarë ose që banojnë në disa shtete të Bashkimit Evropian mund të transferohen për të kryer dënimin në një institucion të një shteti tjetër anëtar të Bashkimit Evropian. Ndonjëherë është e mundur që personi i burgosur të japë konsesnin e tij, ndërsa në raste të tjera ajo vepron edhe pa konsensin e tij. Në çdo rast, ju mund të merrni pjesë në procedurë dhe të shprehni mendimin tuaj në lidhje me transferimin: për ta bërë këtë, është e rëndësishme të kontaktoni një avokat. Është gjithmonë e këshillueshme në këtë procedurë të jetë i mbështetur nga një avokat i besuar: në qoftë se ju nuk keni një avokat të besuar, ju mund të kontaktoni Garantin.

Personat e dënuar të cilët janë qytetarë ose rezidentë të ndonjë nga shtetet e Bashkimit Evropian, mund të transferohen **për të vuajtur dënimin** në një burg të një shteti tjetër të Bashkimit Evropian. **Disa herë është e mundur të kërkohet mendimi i personit të dënuar për transferim, por nga një herë ndodhë që autoritetët të veprojnë pa dëshirën e tij.**

**Ju mund të merrni pjesë e të shprehni opinionin tuaj për procedimin e transferimit:** për të bërë këtë gjë, është e rëndësishme që të flisni me një avokat.

**Është gjithmonë e këshillueshme që në këtë procedurë të jeni në mbrojtje të një avokati të besueshëm:** nëse nuk keni një avokat, mund të viheni në kontakt me Garantin e të burgosurve. Legjislacioni referues përmbahet tek vendimi Gai 2008/909 Ligji i deleguar 88/2009.

### ? Kush mund të transferohet?

Ju mund të transferoheni nëse jeni një **burgosur me nënshtetësi të Komunitetit Evropian**, ose jeni qytetar i një shteti tjetër, edhe pse jeni jashtë Bashkimit Evropian, por keni jetuar rregullisht dhe keni një rezidencë në mënyrë të qëndrueshme në shtetin tjetër të BE-së. Ndër të tjera duhet të gjendeni në institut pas vendimit përfundimtar të procedurës penale (**p.sh. i dënuar në formë të prerë**).

### ? [A ndikon lloji i krimit të kryer në transferimin?](#)

Nëse jeni në burg për shkak se keni kryer një krim veçanërisht të rëndë (duke përfshirë: pjesëmarrjen në një organizatë kriminale, korrupsionin, mashtrimin, vrasjen vullnetare, trafikimin e automjeteve të vjedhura, rrëmbimin, dhunën seksuale, etj.) edhe nëse ai duhet të mbajë një dënim më shumë se tre vjet, mund të transferohet.

**KUJDES!** Nëse ndodheni në **burg sepse keni kryer të tjera vepra penale**, për tu transferuar ju duhet që shteti pritës përkatës të konsidëroje veprën penale të dënushme si një krim të dënuar me ligj penal.

**KUJDES!** Në rastet kur duhen të përshtaten vuajtja e dënimit të shtetit italian me ligjet e shtetit pritës ku do të transferohesh, “**dënimi i ri**” nuk mund të jetë më i rëndë (si për harkun kohor si dhe për llojin e veprës penale) se ai që po vuani në Itali.

### ? [Zbatohet gjithmonë transferimi?](#)

**Nuk është e sigurtë që vendi i destinacionit do të pranojë transferimin: kjo vlen veçanërisht për Rumaninë, për shkak të numrit të lartë të mbipopullimit në burgje.**

Kushti i transferimit është me qëllimin e riedukimit tuaj për të rimarrë pjesë në shoqërinë (sociale): nuk mund të jeni i transferuar nëse vendi i juaj (p.sh. Rumania) nuk ju afron riedukim social (p.sh. nëse nuk keni më familjen tuaj, ose të afërm të tjerë dhe nuk keni mundësi të gjeni punë).

### ? [Drejt cilit shtet anëtarë mund të transferoheni?](#)

- Shtetin në të cilin është shtetas dhe në të cilin ka jetuar;
- Shteti ku keni shtetësinë dhe drejt të cilit do të dërgoheni, nëse është urdhëruar përjashtimi nga vendi ose jeni përzënë;

- Shteti i të cilit jeni shtetas, edhe nëse nuk keni jetuar atje dhe nuk ka urdhër dëbimi në atë vend.

### ? Nëse dëshironi të transferoheni, çfarë duhet të bëni?

Zakonisht vendi në të cilin jeni duke vuajtur dënimin tuaj (Italia) dhe vendi i destinacionit komunikojnë me njëri-tjetrin, POR ju mund ti kërkonti drejtpërdrejt Autoriteteve kompetente të Italisë ose vendit të destinacionit që të nisni procedurën për transmetimin e vendimit të dënimit tuaj, dhe certifikatën që kërkohet për transferimin.

**Duhet të dini se procedurat transferimit kanë nevojë për kohë të gjatë**, dhe nëse ju kanë mbetur më pak se 2 vjet burg nga dënimi, mund të ndodhë që nuk mund të transferoheni para përfundimit të dënimit.

-  
**KUJDES:** Meqëse çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian ka rregullat përkatëse të saja përsa i përket transferimit, nuk është e mundur t'ju tregohet në këtë udhëzues se cila procedurë që duhet të ndiqet me saktësi.

Për këtë arsye, **nëse ju kanë ngelur pak vite për vuajtjen e dënimit në burg dhe dëshironi të transferoheni, përpara se të nisni procedurat** duhet të kontaktoni avokatin tuaj, një operator të besueshëm, ose me zyrën e Garantit të burgosurve.

